

Të dashur prindër.

Urime për lindjen e fëmijës tuaj!

Ne përfitojmë nga kjo ngjarje e lumtur për t'ju informuar mbi rëndësinë e vaksinimit.

Vaksinimi në Zvicër

Plani i vaksinimit zviceran është hartuar nga mjekë specialistë dhe nga Zyra Federale e Shëndetit Publik (OFSP). Plani bazohet në njohuritë e fundit shkencore.

Qëllimi i vaksinave është **të mbrojnë fëmijën tuaj** nga sëmundjet që nganjëherë janë të rënda. Vaksinimi mundëson gjithashtu të mbrohen ata që nuk mund të vaksinohen, si foshnjat, personat me sistem imunitar të dobësuar ose gratë shtatzëna.

Do të gjeni listën e vaksinimeve bazë dhe plotësuese në anën e pasme.

- Vaksinimet bazë mbrojnë fëmijën tuaj dhe popullsinë nga sëmundjet e rënda.
- Vaksinimet plotësuese mbrojnë në radhë të parë fëmijën tuaj.

Informacione plotësuese

Nëse keni pyetje ose dëshironi informacione plotësuese:

- **Pediatër** i cili e njih fëmijën tuaj dhe do të dijë t'ju këshillojë më mirë;
- **Faqe interneti:** www.sevacciner.ch, www.infovac.ch dhe www.ge.ch/protection-vaccination ;
- **Kontakt:** me telefon në 022 546 50 00 ose me email në vaccination@etat.ge.ch.

Shënime të rëndësishme

• Sa kushton ?

Vaksinimi kundër HPV është falas në Gjenevë në programin kantonal. Vaksinimet e tjera bazë dhe plotësuese mbulohen nga sigurimet shëndetësore.

• Për çfarë shërben librezja e vaksinimit ?

Ajo quhet edhe "çertifikatë vaksinimi". Ajo lejon të verifikohen vaksinat e marra nga fëmija juaj. Ruajeni me kujdes dhe merreni me vete në çdo konsultë.

• Kur dhe pse do t'ju kërkohet librezja e vaksinimit të fëmijës suaj ?

Kur fëmija juaj të ketë mbushur 2 vjeç e gjysmë, ne do t'ju kërkojmë një kopje të librezës së tij të vaksinimit. Kjo na lejon të shohim nëse fëmijët janë të mbrojtur nga sëmundjet që mund të shkaktojnë epidemi. Është e nevojshme t'i përgjigjeni kësaj kërkesë, edhe nëse fëmija juaj nuk është vaksinuar.

Vaksinimet bazë të rekomanduara

Vaksina të kombinuara - vakcina që mund të grupohen për të zvogëluar numrin e injeksioneve

- **Difteria:** shkakton një anginë të rëndë, nganjëherë vdekjeprurëse.
- **Tetanozi:** sëmundje vdekjeprurëse që prek sistemin nervor.
- **Kolla e mirë:** sëmundje frymëmarrjeje që mund të jetë shumë e rëndë për fëmijët e vegjël, nganjëherë vdekjeprurëse.
- **Poliomieliti:** mund të shkaktojë paraliza. Është ende i pranishëm në Afrikë dhe në Azi.
- **Haemophilus influenzae:** shkakton meningjite të rëndë tek fëmijët e vegjël.
- **Hepatiti B:** sulmon mëlçinë dhe mund të çojë në cirrozë dhe kancer.

3 doza në 2 muaj, 4 muaj dhe 12 muaj (difteri, tetanoz, kollë e mirë, poliomielit, haemophilus influenzae, hepatit B)
1 përsëritje ndërmjet 4 dhe 7 vjeç (difteri, tetanoz, kollë e mirë, poliomielit).
1 përsëritje ndërmjet 11 dhe 15 vjeç (difteri, tetanoz, kollë e mirë).

- **Fruthi, shytat, rubeola:** ende të shpeshta në Zvicër me komplikime të rënda të mundshme.
- **Lija e dhenve:** mund të shkaktojë komplikime si pneumonia e rëndë.

2 doza në 9 muaj dhe 12 muaj (fruthi, shytat, rubeola, lija e dhenve)

Vaksina individuale (ose monovalente)

- **Pneumokokët:** mund të shkaktojnë meningjite ose pneumoni.

3 doza në 2 muaj, 4 muaj dhe 12 muaj.

- **HPV:** mund të shkaktojë kancer të qafës së mitrës dhe kancere të tjerë (anus, penis, fyt).

2 doza mes 11 dhe 14 vjeç.

Vaksinime plotësuese të rekomanduara

- **Meningokokët:** mund të shkaktojnë meningjite të rëndë.

Meningokokë ACWY: 1 ose 2 doza mes 12 dhe 18 muaj sipas vaksinës, pastaj 1 përsëritje mes 11 dhe 15 vjeç.
Meningokoku B: 3 doza në 3 muaj, 5 muaj dhe mes 12 dhe 18 muaj, pastaj 2 doza mes 11 dhe 15 vjeç.

- **Rotavirusi:** shkakton diarre tek fëmijët nën 2 vjeç.

2 doza në 2 muaj dhe 4 muaj.

Imunizim pasiv

- **VRS:** shkakton bronkiolite dhe sëmundje të rënda tek fëmijët e vegjël.

1 dozë pak pas lindjes.